

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, buxhetit, auditit të brendshëm, zhvillimit strategjik.

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 1 datë 30.03.2026

Nr 622 Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. _____ datë 31.03.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Miratimin e Tavanëve Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029”,

Analiza ligjore: Miratimi i Tavanëve Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, është në mbështetje të nenit 34, pikat 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, të Udhëzimit të MFE nr.23, dt.30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetqeverisjes vendore”, i ndryshuar, Udhëzimit të MF nr.07, datë 27.02.2026, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2027-2029”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.67, datë 17.12.2025, “Për miratimin e kalendarit të PBA 2027-2029”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.08, datë 27.02.2026, “Për miratimin e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave, në kuadër të përgatitjes së PBA 2027-2029”, Vendimit nr.02, datë 19.01.2026, të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve, në kuadër të PBA 2027-2029”.

Situata aktuale e funksionit

Procesi kryesor pas miratimit të parashikimit të të ardhurave afatmesme 2027-2029, është përgatitja nga ana e GMS, e tavanëve përgatitore të PBA 2027-2029 dhe miratimi i tyre nga ana e Këshillit Bashkiak.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë, në cilësinë e Kryetarit të GMS, me vendimin nr.2, datë 19.01.2026, është bërë e mundur ngritja e Grupit të Menaxhimit strategjik (GMS) dhe e Ekipeve të Menaxhimit të programjeve (EMP) dhe Drejtuesve të tyre, ku me shkresën nr.113 prot., datë 19.01.2026, “Dergohen për zbatim kalendarit i veprimtarive për përgatitjen e PBA 2027-2029, Vendimi për ngritjen e GMS dhe EMP-ve” Ju është dërguar për zbatim gjithë Drejtuesve të Programeve Buxhetore.

Në këtë kuadër, puna baze për hartimin e PBA 2027-2029, fillon me miratimin e Tavanëve Përgatitore të shpenzimeve sipas programeve buxhetore dhe dërgimin e tyre pranë Drejtorive

(Ekipëve të Menaxhimit të Programeve), për hartimin në bazë të tyre të Kërkesave Buxhetore, që përfshijnë shpenzimet sipas kategorive ekonomike për produktet dhe projektet e investimeve.

Nëpërmjet tavanëve të shpenzimeve të programeve buxhetore, Bashkia bën të mundur realizimin e qëllimeve, objektivave, aktiviteteve dhe produkteve, që caktojnë EMP-të.

Për të arritur në këtë fazë të përgatitjes së PBA 2027-2029, për Bashkinë tonë, Këshilli i Bashkisë i ka paraprirë me dy vendime, që janë, ai me nr. 67 datë 17.12.2025, "Për miratimin e kalendarit të veprimtarive për përgatitjen e PBA 2027-2029", ku janë përcaktuar afatet detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje me procedurën e hartimit të P.B.A dhe vendimi nr.08, datë 27.02.2026, "Për miratimin e raportit për vleresimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për vitet 2027-2029", ku është përcaktuar metodologjia e përdorur, (kryesisht eksperiencia e viteve të mëparshme); analiza e politikave të reja të administrimit (ku planifikohet rritja e të ardhurave nga burimet tona, pa rritur nivelin e taksave dhe tarifave, pa vendosur taksa dhe tarifa të reja, ose të përkohshme, por vetëm nëpërmjet administrimit më të mire, rritjes së vazhdueshme të bazës së taksapaguesve, luftës kundër evazionit fiskal dhe rritjen e performancës së mbledhjes së detyrimeve debitorë).

Situata financiare :

Në përputhje me objektivat e caktuara, në kuadër të PBA 2027-2029, **Totali i të ardhurave sipas viteve të PBA 2027-2029, paraqitet:**

në (000/lek)

1-Të ardhurat gjithsej për vitin 2027, në vlerën 344.725.

2-Të ardhurat gjithsej për vitin 2028, në vlerën 337.495.

3-Të ardhurat gjithsej për vitin 2029, në vlerën 350.265.

Bazuar në totalin e të ardhurave nga burimet e mësipërme, Grupi për Menaxhim Strategjik, ka diskutuar dhe ka vendosur të paraqesë Këshillit Bashkiak, Tavanet Përgatitore, që janë kufiri më i sipërm i shumës totale të parave, që mund të shpenzohen ose të planifikohen për të shpenzuar për secilin nga 17-të programet (funksionet) buxhetore, duke i dhënë përparësi në krahasim me buxhetin e vitit 2026, menaxhimit të pyjeve kullotave, sidomos për vitet 2028-2029, për investime; Shërbimeve publike, vendore për të gjitha vitet e PBA për investime; MZSH-së për vitin 2028, për investime; dhe trashëgimisë kulturore e turizmit për vitin 2029 për investime.

Pas vendimarrjes Tuaj, do hartohet Udhëzimi për përgatitjen e PBA 2027-2029, nga ana e Kryetarit të Bashkisë dhe do t'ju shpërndahe bashkë me Tavanet Përgatitore të miratuara, të gjitha Ekipëve të Menaxhimit të Programeve dhe Drejtuesve të tyre, të cilat janë miratuar me Vendimin nr.2 datë 19.01.2026, të Kryetarit të Bashkisë.

Hartimi dhe miratimi i Tavanëve Përgatitore të shpenzimeve për çdo Program Buxhetor dhe funksion do bëjë të mundur që çdo Ekip i Menaxhimit të Programit, duke ditur Tavanin Përgatitor, do punojë për përgatitjen e deklaratës së programit, që përfshin qëllimin, objektivat, aktivitetet e programit, burimet, produktet dhe shërbimet që do ofrohen në këtë periudhë nga ana

e Bashkisë përmes çdo programi buxhetor dhe hartimin më tej të Kërkesave Buxhetore, si pjesë e PBA 2027-2029.

Në kuadrin e hartimit të PBA 2027-2029, GMS ka miratuar 17 programe buxhetore për realizimin e aktivitetit të Bashkisë.

Analitikisht Tavanet Përgatitore të shpenzimeve sipas programeve buxhetore, të miratuara nga ana e GMS-së, paraqiten sipas Raportit PBA1 të platformës smbv, faza 1 2027-2029, bashkangjitur.

Në qoftë se krahasojmë, nivelin e shpenzimeve sipas programeve buxhetore, të paraqitura më lart, vërrejmë një rritje të tyre, përgjatë viteve 2028 dhe 2029, në krahasim me planin e vitit 2027, ku rritjen më të madhe e përfaqëson programi, i MZSH-së (03280), në 125%.

Gjithashtu, rritje të konsiderueshme të shpenzimeve për investime, kemi edhe në programin 06260, (Sherbime publike), në 116% .

Po kështu, rritje paraqesin edhe programe të tjera buxhetore, si ai për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, rrjetit rrugor rural, menaxhimit të mbetjeve dhe trashëgimisë kulturore për vitin 2029, përkatësisht në 115%; 106%; 104% dhe 125% .

Theksojmë përfundimisht, se niveli i tavanëve përgatitore të programeve buxhetore, në kuadër të PBA 2027-2029, siguron qëndrueshmërinë dhe rritjen e shërbimeve ndaj komunitetit, garanton vazhdimin dhe përfundimin e investimeve të planifikuara, si edhe plotëson objektivat tona në fushën e aktivitetit social-ekonomik të Bashkisë. Si të tilla, Ju ftojme për ti miratuar.

Drejtoria / sektori përgjegjes:

Drejtoria e Finances dhe buxhetit, pas vendimmarrjes se Grupit te Menaxhimit strategjik te Bashkise.

Monitorimi dhe raportimi :

Komisioni i Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik., dhe keshilli bashkiak, monitorojne ecurine dhe realizimin e aktit, dhe mund te kerkojne raportim periodik per zbatimin e hallkave te pergatitjes se PBA 2027-2029.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt vendim, impakton zhvillimin ekonomik afatmesem të Bashkisë, realizimin e objektivave te PPV vendor, nivelin e shërbimeve vendore ndaj komunitetit, me efekt ne rritjen e mireqenies se qytetareve, nëpërmjet rritjes së investimeve dhe thithjes së fondeve nga projekte, ose programe evropiane.

A është objekt i konsultimit publik:

Ky akt i Keshillit te Bashkise, nuk eshte objekt i konsultimit publik, para se te miratohet nga Keshilli i Bashkise.

Komisioni i Përhershëm i “Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik.” i mbledhur me datën 30 / 03 / 2026, shqyrtoi projekt vendimit nr. 1 datë 30 / 03, 2026, relacionit e dokumentat shoqërues në me propozimin për, “Miratimin e Tavanëve Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029”, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim

b) miratimin e projektaktit

c) refuzimin e miratimit të projektaktit

d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:


✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"


✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"

✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"

✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në "-----"

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit.


Aleksander Bebo Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)


Eliona Hano Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë 30 / 03 2026